


STUDIM MBI VEPRIMTARINË SHKENCORE E JETËSORE
TË DEMUSH SHALËS

Vlorë Fetaj-Berisha, *“Demush Shala mbledhës dhe studiues i folklorit”*,
botoi: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020; 304 f.



Botimi i monografisë *“Demush Shala mbledhës dhe studiues i folklorit”*, i autorës Vlorë Fetaj-Berisha, është rezultat i punës së përpunimit dhe plotësimit të temës së saj hulumtuese e përgatitëse të doktoratës, të mbrojtur në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe të Artit, në Tiranë, nën udhëheqjen e prof. dr. Agron Xhagolli, që doli nga shtypi në vitin 2020, si botim i veçantë i Degës së Folklorit të Institutit Albanologjik në Prishtinë.

Në këtë monografi, autorja përmbledh në tërësi veprimtarinë profesionale të prof. Demush Shalës, i cili krahas edukimit të brezave të tërë si pedagog i letërsisë popullore, organizoi studentët e tij në mbledhjen e materialeve të ndryshme folklorike, që në atë kohë nuk ishte bërë mjaftueshëm në Kosovë. Materialet folklo-

rike të mbledhura në terren nga studentët, u bënë mbështetje empirike për përgatitjen e seminareve, por njëkohësisht edhe një mundësi orientimi për breza të tërë studentësh të tij, studiuesish të ardhshëm, të cilët u përcaktuan për studimin e folklorit si veprimtari e tyre profesionale. Krahas këtij angazhimi, prof. Shalau mor edhe mesistemimin, klasifikimin dhe studimin e folklorit shqiptar, të cilin e trajtoigjithmonë si një tërësi dhe jo si folklor i hapësirave të shkëputura. Këto arritje i botoi në revista të ndryshme shkencore apo në botime të veçanta për folklorin në Kosovë, po edhe në Shqipëri. Si njohës i mirë i trashëgimisë folklorike, prof. Shala, në punën e tij studimore shkencore pati parasysh të gjitha arritjet e deriatëherëshme në këtë fushë, por që interesi i tij më i thelluar ishte në shtrimin e çështjeve të krijimtarisë popullore shqipe në Kosovë, si dhe në dhënien e një tabloje të plotë rreth pranisë dhe funksionimit të llojeve të ndryshme të folklorit, si ato: historike, lirike, legjendare, epike, anekdotave etj.

Autorja Fetaj-Berisha ka ndërmarre realizimin e këtij punimi monografik, për angazhimin dhe veprimtarinë profesionale të prof. Demush Shalës, për shkak të vlerave dhe meritave që përcjellin punën e kësaj figure, si dhe kontributit të tij pedagogjik e profesional për folkloristikën shqiptare. Në përgatitjen e kësaj monografie është përdorur metoda e përshkrimit në tërësi e veprimtarisë pedagogjike, regjistruese dhe studimore e botuar nga prof. Shala, si dhe ajo e lënë në dorëshkrim në dosjen e tij, si bashkëpunëtor në arkivin e Institutit Albanologjik në Prishtinë.

Kjo monografi është strukturuar në pesë kapituj, në kapitullin I, që pason pas hyrjes, bëhet përmbledhja e tërë kontributit të prof. Shalës, në mbledhjen, regjistrimin dhe klasifikimin e materialeve folklorike dhe përgatitjen për botim në vëllime përkatëse. Autorja për secilin vëllim të përgatitur nga Shala, vlerëson kontributin e tij në dëshminë që bëri ai për këtë pasuri të madhe të folklorit në Kosovë dhe më gjerë, duke hedhur dritë sidomos në lloje të veçanta folklorike dhe të përhapjes së motiveve të ndryshme të këtyre llojeve, të cilat praktikoheshin dhe bënin jetë aktive në Kosovë në atë kohë.

Në kapitullin II, autorja përmbledh kontributin e prof. Shalës në studimin kryesisht të epikës historike të folklorit shqiptar, si edhe të këngëve kreshnike, duke u bërënjë nga emrat e spikator, jo vetëm brenda Kosovës, por në të gjitha hapësirat shqiptare, sidomos në kohën e vështirësive të

komunikimit brenda folkloristëve shqiptarë. Me punën e tij shkencore, ai ishte i pranishëm në qarqet studimore të folklorit në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Luginë të Preshevës, me një fjalë në të gjitha viset shqiptare.

Në kapitullin III, janë përmbledhur kontributet e prof. Shalës, si punime të botuara në revista të ndryshme shkencore, recensione vlerësuese, si dhe kritika e polemika të cilat i zhvilloi në atë kohë me anë të shkrimeve me studiues të tjerë, kryesisht për çështje të klasifikimit të prozës gojore, si dhe për metodologjinë e punës hulumtuese të folklorit në Kosovë.

Ndërsa, në kapitullin IV, autorja përmbledh kontributet e tjera të prof. Shalës, si në vlerësimin e disa nga figurat e shquara të kulturës shqiptare, mbi emancipimin e gruashshqiptare, si dhe në hartimin e dispensës dhe librave të ndryshëm shkollorë për nevojat arsimore.

Në kapitullin V, Fetaj-Berisha ofron një kronologji jetësore të prof. Demush Shalës dhe një bibliografi të plotë të veprimtarisë së tij profesionale, studimore individuale dhe në bashkëpunim me autorë të tjerë. Ndërkaq, në përfundim, autorja bën një rikapitullim përmbajtësor të kapitujve.

Monografia e autores Vlorë Fetaj-Berisha “*Demush Shala mbledhës dhe studiues i folklorit*”, vjen si një sintezë veprimtarisë hulumtuese e shkencore dhe jetësore të prof. Demush Shalës, me përpykjen për të nxjerrë në pah vlerat e punës së tij, si dhe për të vënë në spikamë individualitetin e tij si mbledhës, klasifikues

dhe studiues i folklorit në Kosovë. Me grumbullimin e studimeve të botuara prej prof. Demush Shalës në gazeta dhe revista shkencore, por edhe të materialeve folklorike në: arkivin dhe bibliotekën e Institutit Albanologjik, Arkivin Kombëtar të Kosovës, Arkivin e Prizrenit, arkivat e shkollave të larta pedagogjike në Prizren dhe Prishtinë (tani Fakulteti i Edukimit), Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, si dhe nga fondi i familjes së prof. Demush Shalës, autorja Vlorë Fetaj-Berisha ka arritur që me këtë monografi të faktojë kontributin e njërit ndër pedagogët dhe studiuesit e parë të folklorit shqiptar në Kosovë.

Leontina GEGA-MUSA

